


GUIDA STUDENTORE


Vizioni

Vizioni i Universitetit POLIS është të ofrojë ekselencë në edukimin e profesionistëve dhe kërkuesve shkencorë të aftë për të adresuar nevojat e tregut dhe shoqërisë në fushat e interesit në vend dhe jashtë tij. Për këtë Universiteti POLIS ka këto synime kryesore:



A të pajisë studentët me cilësitë e lidërsnip-it profesional në fushat që mbulon në mënyrë që të ushtrojnë influencë për zhvillim pozitiv të vendit dhe rajonit;
B të pajisë studentët me njohuri teorike dhe aftësi praktike sipas standardeve më të larta bashkëkohore duke synuar integrimin e tyre në tregun e punës vendas dhe ndërkombëtar;
C të kryejë aktivitete studimore, kërkimore, shkencore dhe praktike të lidhura ngushtë me veprimtarinë akademike dhe programet e studimeve që zhvillon;
D t'i shërbejë inovacionit ne fushat ku shtrin veprimtarinë e tij si dhe të ndikojë, në këto fusha, zhvillimet në rajon.
E Universiteti POLIS synon të kthehet në një platformë rajonale dhe pikë reference në Ballkan dhe rajonin e Adriatikut dhe Jonit.

ETI POLIS



Misioni

Misioni i Universitetit POLIS është përcaktuar më aktin e tij të themelimit sipas vendimit të gjykatës cituar në nenin 1, pika 2 dhe është i fokusuar në veprimtari të edukimit, kërkimit shkencor e të aplikuar dhe të inovacionit në fushat e tij të interesit.



Universiteti POLIS ka në themel të misionit të tij këto objektiva:

A të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe të aplikuar si dhe inovacionit;

B të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj në fushën e dizajnit, arkitekturës dhe inxhinierisë, shkencave të territorit, menaxhimit dhe politikave të zhvillimit;

C të ofrojë studime në nivelin e Diplomës Profesionale, Bachelor-it, Masterit dhe Doktoratës për fushat e përcaktuara më sipër;

D të ofrojë mundësinë e formimit profesional dhe të mësuarit gjatë të gjithë jetës;

E të integrojë mësimdhënien me kërkimin shkencor;

F të kontribuojë nëpërmjet edukimit, kërkimit shkencor dhe të aplikuar, dhe inovacionit në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të vendit;

G të kontribuojë për ndërkombëtarizimin e arsimit të lartë dhe shkencës në vend nëpërmjet bashkëpunimit rajonal, europian dhe ndërkombëtar.





struktura ORGANIZATIVE


Universiteti POLIS është institucion i arsimit të lartë që vepron në fushën e arsimit, kërkimit shkencor, veprimtarive krijuese dhe profesionale, i organizuar në nivele të ndryshme dhe ka autoritetet e veta brenda këtyre niveleve. Universiteti POLIS përfaqëson një strukturë të integruar dhe të përbërë nga njësi kryesore, njësi bazë dhe njësi të tjera, sipas përcaktimeve të statutit të institucionit. Ai ka në përbërje tre njësi kryesore.

FAKULTET

departament institutet labo

A

B



Në strukturën organizative të Universitetit POLIS dallohen 4 (katër) lloje njësish përbërëse organizative:

A Njësi kryesore është Fakulteti dhe/ose Instituti (kur ky i fundit plotëson të njëjtat standarde si Fakulteti);

B Njësi bazë është departamenti dhe qendra kërkimore;

C Njësi ndihmëse janë laboratorë, atelie, studio profesionale etj.;

D Qender Studimore Ndërdisciplinore Kërkimore dhe Inovacioni – Universiteti POLIS ka një qender studimore ndërdisciplinore synimi kryesor i së cilës është promovimi i të gjitha praktikave, metodologjive dhe qasjeve kërkimore dhe inovative që sjellin risi në fusha të ndryshme të shkencës dhe teknologjisë. Ajo vepron si një njësi ndërdisciplinore që kombinon aktivitetet e njësive kryesore me qëllim sjelljen dhe nxitjen e zgjidhjeve të reja krijuese dhe eksperimentale.


laboratore/atelier qender kërkimi


C

D

FAD

Fakulteti i
Arkitektures,
dhe Dizajnit





1. Departamenti
ART DHE DIZAJN;


2. Departamenti
**ARKITEKTURË
dhe INXHINIERI;**




3. Qendra **KËRKIMORE NË
ARKITEKTURË, INXHINIERI
DHE DIZAJN;**

FPMMU

Fakulteti
Planifikim,
Mjedis dhe
Menaxhim Urban



**1. Departamenti PLANIFIKIM
dhe MENAXHIM URBAN;**



2. Departamenti i MJEDISIT;



**3. Qendra KËRKIMORE e
QËNDRUESHMËRISË;**


IKZH

Instituti per
kerkim zhvillim




**1. Departamenti i
KËRKIMIT SHKENCOR;**

**2. Departamenti i KËRKIMIT
TË APLIKUAR;**



**3. Qendra e BURIMEVE
dhe INFORMACIONIT;**



QSNKI

Qendra

Studimore

Nderdisiplinore

Kerkimore dhe e

Inovacionit

INNOVATION_Factory është një qender studimore ndërdisiplinore kerkimore dhe inovacioni pranë Universitetit POLIS. Synimi kryesor është promovimi i të gjitha praktikave, metodologjive dhe qasjeve kërkimore që sjellin risi në fusha të ndryshme të shkencës dhe teknologjisë. Ajo vepron si një re ndërdisiplinore që kombinon aktivitetet e dy fakulteteve dhe IKZH-së me qëllim sjelljen dhe nxitjen e zgjidhjeve të reja krijuese dhe eksperimentale.



SK  

Sekretaria
Mesimore

Sekretaria Mesimore eshte nje nga njesite me te rendesishme per funksionimin e Universitetit POLIS dhe stabilizimin e nje raporti sa me korrekt sherbimesh dhe dokumentimi midis komunitetit studentor dhe stafit akademik. Sekretaria Mesimore funksionon ne baze te nje sistemi elektronik te dhenash dhe kujdeset per garantimin dhe mirefunksionimin e infrastruktures mesimore. Ekipi i kesaj njesie mbulon sherbimet per te gjitha programet Full time dhe Part time, duke mbuluar madje edhe fundjaven.

Pervec te tjerave, Sekretaria Mesimore eshte nje pike e mire hyrjeje edhe per ata qe interesohen per te ndjekur studimet ne U_POLIS, duke ndermjetesuar konsulta edhe me Zyren e Marketimit dhe Zv. Dekanet.

ZMSKK

Zyra e
Mbeshtetes se
Studenteve dhe
Keshillimit te
Karrieres



Zyra e Mbështetjes së Studentëve dhe Keshillimit të Karrierës është një njësi e cila asiston dhe ndjek studentet, si gjatë kohës së ndjekjes së studimeve, ashtu edhe pas mbarimit të saj, duke krijuar një database me të dhëna për karrierën, suksesin dhe vështirësitë e studentëve gjatë pershtatjes në treg, arritjet e tyre, lobimin për mbrojtjen e të drejtave të profesionit, përmes shoqatës AUA (Unioni i Arkitekteve, Urbanistëve dhe Planifikuesve Urbane), ruajtjen e lidhjes me POLIS përmes Shoqatës ALUMNI, inkurajimin e frymës së bashkëpunimit si komunitet, mbështetjes dhe filantropisë. Qëllimi ZMSKK si strukturë në vetvete është i orientuar drejt mbajtjes së kontaktit të vazhdueshëm si dhe dhënies së informacionit shumëdrejtimesh. Informacioni përmbledh informacion për studime, programe të ndryshme, orientim për karrierën ose orientimin profesional si dhe këshillim individual ose në grup



procedurat e regjistrimit dhe sistemi elektronik

DOKUMENTACIONI PËR REGJISTRIM

<http://www.universitetipolis.edu.al/?q=sq/node/43>

TRANSFERIMI I STUDIMEVE

Procedura e transferimit për studimet bachelor dhe programe të integruara këtu:

http://www.universitetipolis.edu.al/sites/default/files/pdf/STRUKTURA%20AKADEMIKE/Transferim_bachelor_prg_integruara_al.pdf

PROGRAMET E STUDIMIT

<http://www.universitetipolis.edu.al/?q=en/node/1622>



SISTEMI ELEKTRONIK


Që prej vitit akademik 2013-2014, U_POLIS disponon një sistem informacioni dixhital plotësisht funksional (OSIRIS EMIS ofruar nga MC Networking), i cili është lehtësisht i aksesueshëm dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë nga stafi dhe studentët, si edhe nëpërmjet faqes zyrtare Portali.

(<http://46.183.121.39/polis.mcn.al/platforma/form1.wgx>)

Portali i Studentit në sistemin dixhital ofron akses të drejtpërdrejtë për të dhënat personale të studentit, siç janë:

1. Orari mësimor, për çdo semester
2. Pjesëmarrja, (njofton studentin kur është pranë limitit të lejuar të mungesave)
3. Studenti mund të konsultojë programet e lëndëve, (syllabuset), dhe literaturën (Biblio_POLIS)
4. Notat, (me gjithë komponentet e vlerësimit)
5. Njoftimet për detyrimet e tyre të prapambetura në kurset përkatëse
6. Studenti kryen edhe vlerësimin e pedagogut (në përfundim të çdo semestri)
7. Njoftime nga sekretaria në lidhje me procesin mësimor





UNIVERSITETI POLIS

Adresa:

Rr. Bylis 12, Autostrada Tiranë-Durrës, Km 5, Kashar,
Kodi Postar 1051, Kutia Postare 2995
Tiranë, Albania

TEL:

+355(0)4 2407420 / +355 (0)4 2407421/
+355 (0) 69 40 88 111

EMAIL:

contact@universitetipolis.edu.al

WWW.UNIVERSITETIPOLIS.EDU.AL